



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:144798
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05504590

C.nr.2337/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Dora Bajrami, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses H.K. nga Prizreni numër personal të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve; Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ...” nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson e autorizuar V.I.Xh. me objekt kontesti pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,184.64 euro, jashtë seance, me datë 26.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses H.K. nga Prizreni,
- II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:
 1. Për periudhën kohore Korrik - Dhjetor 2019, në shumën prej 68.16 euro;
 2. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2020, në shumën prej 10.10 euro;
 3. Për periudhën kohore Janar - Dhjetor 2021, në shumën prej 171.76 euro;
 4. Për periudhën kohore Janar – 21.11.2022, në shumën prej 468.29 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 718.31 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (18.07.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesë padisë, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II të këtij dispozitivi, e në shumë prej 466.33euro.

A r s y e t i m

Paditësja H.K. nga Prizreni në këtë gjykatë me datë 18.07.2022, përmes të autorizuarit të saj Shoqëria e Avokatëve; Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ...” nga Prishtina, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit me vlerë të kontestit 1184.64 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune në shkollën fillore të mesme e ulët “Abdyl Frashëri” në Prizren, dhe bazuar në nenin 35 par.10, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore për vitet 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj me dt. 08.12.2023 ka kërkuar që paditëses t’i njihet e drejta e kompensimi mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me dt. 21.11.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2017 në 1.5%, për vitin 2018 në 1.1%, për vitin 2019 në 2.7%, për vitin 2020 në 0.2%, 2021 në 3.4% dhe për vitin 2022 në 10.4% në pagën e kërkuar prej 521.64 euro e në shumë totale prej 1184.64 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 28.10.2022, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Paditësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë paditëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e paditëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës të R. Kosovës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Tutje ka shtuar se e drejta për kompensim të inflacionit për vitet 2017, 2018, 2019 është parashkruar, sipas nenit 353 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve kjo e drejtë është parashkruar. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës me numër 290/18 e dt. 10.11.2015 për paditësen e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në shkollën “Abdyl Frashëri” në Prizren, si mësimdhënëse që nga data 01.12.2015.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2020, 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të paditëses e që është shuma prej 421.00 euro.

Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit për vitin 2019 ka qenë 2.7%, për vitin 2020 ka qenë 0.2%, për vitin 2021 ka qenë 3.4% dhe për vitin 2022 ka qenë 11.6%. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”*, si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”*, ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.07.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 68.16 euro ($421 * 2.7\% = 11.36 * 6 \text{ muaj} = 68.16 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 10.10 euro ($421 * 0.2\% = 0.84 * 12 \text{ muaj} = 10.10 \text{ euro}$).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në

vitin 2021 ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është $171.76 \text{ euro} (421 * 3.4\% = 14.31 * 12 \text{ muaj} = 171.76 \text{ euro})$.

- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.6%, mirëpo në kërkesën e paditësit është kërkuar në shkallë të inflacionit prej 10.4%, në këtë drejtim gjykata në kuptim të nenit 2.1 të LPK-së, “vendos brenda kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, andaj duke pasur parasysh kërkesën e paditësit dhe se paga bazë e paditësit në vitin 2022, ka qenë 421.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është $467.02 \text{ euro} (421 * 10.4\% = 43.78 * 10 \text{ muaj} = 437.84 \text{ euro})$ si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 32.55 euro sipas $(43.78/30 = 1.45 * 21 \text{ ditë} = 30.45 \text{ euro}) = 437.84 + 30.45 = 468.29 \text{ euro}$.
- Në shumën e përgjithshme prej 718.31 euro e llogaritur shkallën e inflacionit për 4 vite (2019, 2020, 2021, 2022).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që: “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë*”, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që “*Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija*”, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse.

Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 18.07.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë të paraqitjes së padisë.

Me paraqitjen e padisë, në gjykatë më datë 18.07.2022 në kuptim të nenit 369 të LMD-së, është ndërprerë parashkrimi për periudhën 01.07.2019 e deri më 21.11.2022, edhe përkundër faktit se padia është parashtruar më datë 18.07.2022 gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë në tërësi për muajin korrik 2019, pasi që parashkrimi për kërkesën e paditësit për muajin korrik 2019 ka filluar të rrjedh vetëm pasi që i njëjti ka pranuar pagën e këtij muaji, e cila i realizohet në fund të muajit, rrjedhimisht e njëjta pas pranimit të kësaj page është njoftuar se e paditura nuk e ka përbushur detyrimin për kompensimin e inflacionit për muajin korrik 2019 dhe nga fillimi i muajit vijues saktësisht gusht 2019, e njëjta ka mundur të kërkoj përbushjen e detyrimit, në bazë të nenit 342 të LMD-së, me të cilin parashihet që “*Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar për 2 vite e 3 muaj.

Gjithashtu gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke ia njohur paditëses kompensimin mbi bazën e përqindjes së inflacionit, në pagën bazë të cilën e realizon paditësja dhe atë në shumën prej 421 euro, duke u bazuar në listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2019, 2020, 2021 dhe 2022, ku vërtetohet lartësia e pagës bazë e paditëses, e që është shuma prej 421.00 euro dhe jo siç është kërkuar nga paditësja në shumën prej 521.64 euro, pasi që kjo shumë përfshinë në vetë edhe shtesat në pagë që i realizon paditësja.

Andaj mbi këtë bazë gjykata refuzoi të pabazuar kërkesën e paditëses sikurse në pikën nën IV. të dispozitivit të aktgjykimit dhe atë sa i përket parashkrimit të kërkesës për 2 vite e 3 muaj (nga data 17.04.2017 deri me dt. 30.06.2019) si dhe duke e minusuar shumën e kërkuar në raport me pagën bazë të kërkuar nga paditësja në shumën prej 521.64 dhe asaj që paditësi e realizon e në shumën prej 421 euro, e në shumën e përgjithshme prej 466.33 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (18.07.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse, lidhur me kërkesën e palës paditëse që kamata të llogaritet si në vlerën e specifikuar në precizimin e dt. 08.12.2023 në shumën prej 94.77 euro, të njëjtën gjykata e gjeti si të pabazuar pasi që kjo shumë e kamatës është llogaritur sipas kërkesës kryesore të specifikuar në precizimin e dt. 08.12.2023, e të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar pjesërisht si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2337/2022, datë 26.03.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

Numri i lëndës: 2022:144798
Datë: 26.03.2024
Numri i dokumentit: 05504590

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.